Lajmet

05/05/2020

Tiranë – Denoncimi nga qytetarët në Komisariatin Dixhital dhe reagimi i menjëhershëm i shërbimeve të Komisariatit të Policisë Nr. 2 vënë në pranga 27-vjeçarin

27-vjeçari ushtronte veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve dhe shitjes e mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve.

Sekuestrohet municion luftarak, armë gjahu, dorezë grushti, shkop gome dhe shkop metalik si ata që përdor Policia.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Nr. 2, pas denoncimit të ardhur në Komisariatin Dixhital se një shtetas, në rrugën "Irfan Tomini", shiste drogë, armë luftarake dhe sportive, kanë organizuar punën për identifikimin, lokalizimin dhe kapjen e personit që ushtronte këtë veprimtari kriminale.

Si rezultat i reagimit të shpejtë dhe informacioneve të marra u bë i mundur identifikimi dhe kapja në flagrancë e shtetasit G. D., 27 vjeç, banues në Tiranë.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e këtij shtetasi, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale një dorezë metalike (Përforcues grushti), një shkop shufër metalike me tri hapje, një shkop gome me hapje si ata të Policisë, një armë gjahu çifte dhe municion luftarak.

Materialet do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Prodhimi dhe mbajtja pa leje armëve të gjuetisë dhe sportive","Prodhimi, mbajtja, blerja apo shitja pa leje armëve të ftohta" dhe "Mbajtja pa leje e armëve shpërthyese dhe municioneve".

Share | Share | Share | Share | Email

Tiranë – Strukturat e Policisë, krahas angazhimit për zbatimin e masave të marra për parandalimin e përhapjes së COVID-19, kanë vijuar punën për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë

Vlorë – Kapet një tjetër person i shpallur në kërkim ndërkombëtar për veprimtari kriminale në fushën e narkotikëve

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- Arkiva
- Akademia e Sigurisë
- Ministria e Brendshme
- Shërbimi Për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat
- Interpol
- Europol
- Misioni PAMECA V
- SCPA
- Projekti Trivalent

Copyright © 2020 Policia e Shtetit.